



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 21 shtator 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Vezira Emrush dhe Qamile Morina.

Mungoi: Vezira Emrush.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Enis Halimi – zyrtar i fushës, Liridon Selmanaj - KDI, Nora Sahatçiu – UNDP dhe Besart Mustafa - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 07. 09. 2010,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin Ekonomik-Social para miratimit në parim,**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinave,**
5. **Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit,**
6. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 07. 2010

Deputetja, Gjylnaze Syla, pati një vërejtje të natyrës teknike në procesverbal. Pas kësaj kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pas vërejtjes dhe korrigjimit të përmendur.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin Ekonomik-Social para miratimit në parim

Sadik Idriz - Ky Projektligj është i pakos së dialogut social. Mendoj se ky Projektligj duhet të shkojë në shqyrtim të parë në seancën plenare. Nëse dikush mendon se ky Projektligj është apo nuk është i nevojshëm, atëherë do të ishte mirë që në seancë të diskutohet për këtë. Kam njoftime se Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e ka tërhequr Projektligjin për skemën e ndihmës sociale, në mënyrë që të shihet se cila materie rregullohet me ligjet, të cilat janë në procedurë, si p.sh.: me Projektligjin për invalidët, për dëshmorët dhe për veteranët e UÇK-së. Arsye tjetër është se tash po punon grupi i punës në Projektligjin për pensionet.

Flora Brovina - Sigurisht dialogu social është i nevojshëm, por nuk e di si e kanë të rregulluar shtetet e tjera këtë çështje, pra a e kanë të rregulluar me ligj këtë çështje? Ne mund ta votojmë, por dilema ime e vetme personale është se a e rregullojnë shtetet e tjera këtë fushë me ligj apo jo?

Teuta Hadri - Se a ka nevojë që ky Projektligj të miratohet apo jo, është mirë të bisedojmë në grupet tona parlamentare. Pra, t'i jepet mundësia të paraqitet në seancë. Çështje tjetër është a do të tërhiqet apo do të procedohet tutje ky projektligj.

Gjylnaze Syla - Rekomandimi për seancë duhet të jetë që Komisioni t'i parashtrojë dilemat e veta se a është e nevojshme që kjo sferë të rregullohet me ligj.

Sadik Idriz - Komisioni në parim nuk ka asgjë kundër që kjo sferë të rregullohet, por dilema e vetme është se kjo materie në shtetet e tjera a rregullohet me ligj apo me ndonjë akt tjetër nënligjor.

Nurishahe Hulaj - Është një ligj specifik që e mundëson nxitjen e dialogut social trepalësh. Ne e kemi pasur Letrën e Bardhë dhe, në një mënyrë, kjo është marrë nga Letra e Bardhë. Ky nuk përmban shumë implikime buxhetore. Duke e ditur rëndësinë e tij që e ka për vendin, unë jam që ky të përkrahet.

Rita Hajzeraj - Është më mirë që kjo fushë të rregullohet me ligj. Ne do ta japim mendimin tonë edhe në grupet parlamentare. Pastaj do ta dëgjojmë arsyetimin e Qeverisë në shqyrtimin e parë për këtë Projektligj. Unë e përkrah këtë Projektligj, por duhet të shkojë në seancë plenare për shqyrtimin e parë.

Gjylnaze Syla - Projektligji ka implikime buxhetore, si për angazhim të ekspertëve, të grupeve të ndryshme negociuese, për pagesat paushalle etj. Evropa këtë çështje nuk e

rregullon më ligj të veçantë as me direktivë, por e rregullon me samit, në të cilin vendosen parimet e formimit të këtij këshilli.

Flora Brovina - Po të rregullohej kjo çështje më ligj, në një mënyrë do të futej në një kontroll qeveritar dhe e humbin pavarësinë palët e tjera përkatëse, që nuk janë pjesë e institucioneve, si p.sh.: sindikatat dhe punëdhënësit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, megjithëse ka dilema se a ka nevojë të rregullohet kjo fushë me ligj të veçantë, e mbështet Projektligjin në fjalë që të shqyrtohet në parim në seancën plenare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale

Sadik Idriz - Mendoj se kemi punuar shumë në këtë Projektligj dhe tash është koha ta përfundojmë punën rreth tij. Grupi i punës i ka harmonizuar qëndrimet me Komisionin për Legjislacion dhe me Komisionin për Buxhet. Çështje e diskutueshme ka qenë pozita e shefit të Agjencisë për Produkte Medicinale, pra çështja për mënyrën e zgjedhjes së tij.

Rita Hajzeraj - Është punuar shumë në këtë Projektligj. Vlerësimet e ekspertit, për nenin 24, që ka të bëjë me mënyrën e zgjedhjes së drejtorit të Agjencisë, kanë qenë se në fillim kjo procedurë është përcaktuar sipas Ligjit për shërbimin civil, që ka qenë më parë. Tash është miratuar Ligji për shërbimin civil dhe ka qenë dashur të ndërrohej e tërë mënyra e zgjedhjes së tij, që të jetë në përputhje me ligjin e ri. Për këtë arsye kanë ardhur kritikën e komisionit përkatës. Tash i kemi harmonizuar qëndrimet me Komisionin për Legjislacion, që drejtori i Agjencisë të zgjidhet sipas Ligjit për shërbimin civil. Kemi biseduar edhe për komisionin etik dhe jemi pajtuar që nuk ka komision etik, por këtë komision ta quajmë komision profesional të etikës. Edhe pse nuk ishte për konsultim kryetari i Komisionit për Buxhet, duhet të sqarohemi në seancë se laboratorit për produkte dhe pajisje medicinale nuk ka implikime buxhetore shtesë, sepse një laborator i tillë ekziston.

Sadik Idriz - Pra, këtu është fjala për komisionin profesional të etikës, i cili merret me çështjet etike profesionale. Ky nuk është komision, i cili ka të bëjë p.sh. me çështjet e suspendimit të punëtorëve etj. Ky është komision profesional i etikës dhe nuk ka kompetencë për masa disiplinore. Sa i përket Komisionit për Buxhet, këto çështje, që kanë të bëjnë me laboratorin, duhet të sqarohen para seancës ose në seancë.

5. Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit

Sadik Idriz - Këtë çështje e kemi shtyrë disa herë. Mendoj se nuk mund të jemi shumë të përpiktë, sepse ndërkohë po na vijnë gjëra të reja dhe planin e punës duhet ta përshtatim në bazë të nevojave që i kemi. Duhet të punojmë me plan. Mendoj se me punën tonë jemi brenda planit. Në këtë periudhë kemi shumë projektligje të rëndësishme për shqyrtim, si Projektligjin e punës, Projektligjin për invalidët e UÇK-së etj. Ndërkohë do të na vijë edhe Projektligji për pensionet.

Teuta Hadri - Mendoj se duhet të ngutemi me Projektligjin e punës që të futet në procedurë sa më shpejt.

Sadik Idriz - Sa i takon Projektligjit të punës, do ta kemi një takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore. Pastaj do të takohemi edhe me ministrin e Punës dhe me ministrin e Financave, që të bisedojmë për disa çështje me rëndësi për këtë Projektligj, sepse nuk mund ta përgatisim Projektligjin pa i harmonizuar qëndrimet me ta. Secili duhet të bisedojë në grupet e veta parlamentare, që gjatë procedimit të Projektligjit të mos kemi probleme.

Qamile Morina - Për shkak të implikimeve buxhetore ky Projektligj është kthyer disa herë. Duhet të angazhohemi t'i përmbushim pritjet e njerëzve për pushimin e lehonisë. Megjithatë duhet të jemi realistë dhe, pse jo, të mendojmë që pushimi i lehonisë të mos përfshihet në Projektligjin e punës, por të jetë projektligj në vete. Qëllimi ynë duhet të jetë që Projektligji i punës, gjithsesi, të miratohet. Nëse ekziston rreziku që ky projektligj të mos kalojë, për shkak të pushimit të lehonisë, atëherë ta shqyrtojmë mundësinë që pushimin e lehonisë ta rregullojmë me një ligj tjetër të veçantë.

Flora Brovina - Kemi vendosur që grupi i punës të diskutojë për të gjitha dilemat që ekzistojnë për Projektligjin e punës. Kur ishim në Zvicër u patëm marrë vesh të takohemi me ministrin e Punëve të Brendshme, me ministrin e Punëve të Jashtme, ministrin e Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe ministrin e Shëndetësisë, që t'i diskutonim problemet për pensionet e Zvicrës. Kërkoj që brenda javës së ardhshme të na mundësohet një takim, do të ishte mirë të bëhet para se të takohemi me sindikalistët që do të vijnë nga Zvicra.

Rita Hajzeraj - Duhet të punojmë shumë të kalojë sa më shpejt Projektligji i punës, sepse për këtë e kemi pasur një takim edhe me kryetarin e Kuvendit dhe jemi dakorduar që ky të kalojë brenda shtatorit. Është mirë që sot të caktohet koha kur do të bëhet vizita në Slloveni. Është mirë që para kësaj vizite të takohemi me të dy ministrat.

Gjylnaze Sylja - Në planin e punës parashihet që Komisioni ta shqyrtojë Projektligjin për shëndetësi në shtator, sepse tash nuk e kemi. Propozoj ta heqim dhe të përqendrohemi të Projektligji i punës. Në shtator dhe në tetor Komisioni duhet ta shqyrtojë Projektligjin për invalidët dhe për dëshmorët e luftës. Po ashtu, është mirë që në shtator ta hartojmë një raport për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin.

Nurishahe Hulaj - Duhet të angazhohemi që projektligjet e parapara për këtë vit të mos shtyhen, por të kryhen brenda këtij viti. Sa i takon Projektligjit të punës, kemi planifikuar që grupi i punës të shkojë dikund, në ndonjë vend, brenda Kosovës dhe ta shqyrtojë projektligjin me të gjitha amendamentet.

Teuta Hadri - Plani i punës është shumë i mirë dhe nuk jam për ndryshime, sepse edhe Projektligji për shëndetësi është i rëndësishëm dhe nuk duhet të shtyhet.

Sadik Idriz - Mund të jetë marrë vendim që Projektligji i punës të miratohet brenda shtatorit, por kjo është e pamundur edhe po të jetë i hartuar që sot. Projektligji duhet t'i

kalojë të gjitha procedurat përkatëse nëpër komisione, po kjo është e pamundur të kryhet brenda shtatorit. Është një kërkesë nga Ministria e Punës, të takohemi me ekspertin e Bankës Botërore dhe me përfaqësuesit e Ministrisë, me dyer të mbyllura, më 1 tetor. Aty do t'i dëgjojmë argumentet e tyre. Për ta proceduar tutje këtë Projektligj duhet të dakordohemi edhe me Qeverinë, e cila është sponsor i Projektligjit.

6. Të ndryshme

Nora Sahatçiu - Jemi në pritje të konfirmimit të datave për realizimin e udhëtimit në Slloveni. Vizita atje ka karakter të shumëfishtë dhe nuk është vetëm për Ligjin e punës. Kisha dashur të diskutojmë për numrin e takimeve dhe për agjendën në përgjithësi, sepse kjo agjendë nuk është përfundimtare.

Qamile Morina - Mendoj se takimet në Slloveni do të na ndihmonin shumë sa i përket Projektligjit të punës. Ne më parë jemi marrë vesh që ky udhëtim të bëhet në shtator, ndërsa, sikur po thuhet tash, po mbetet për fund të tetorit. Konsideroj se është shumë vonë të bëhet në atë kohë.

Sadik Idriz - Kjo vizitë është shtyrë për shkak se s'kemi mund të organizoheshim ta bënim para pushimit të verës. Vizita jonë tash nuk lidhet vetëm për Projektligjin e punës, ndonëse në fillim ka qenë e lidhur me të. Është me rëndësi ta organizojmë mirë dhe të kemi vizitë të frytshme.

Gjylnaze Syla - Pasi para pushimeve s'kemi mundur të organizoheshim të shkonim dhe e kemi anuluar vizitën atje, tash nuk duhet t'u bëjmë trysni zyrtarëve sllovenë. Për këtë duhet të jemi më seriozë. Do të bënim mirë të takohemi edhe me zyrtarët e Ministrisë së Punës së Sllovenisë dhe me përfaqësuesit e sindikatave të Sllovenisë.

Sadik Idriz - Duhet t'i propozojmë emrat për formimin e grupit të përbashkët të punës për Projektligjin për invalidët e UÇK-së.

Komisioni konstatoi se përgatitjet për vizitë në Slloveni janë duke shkuar mirë. Komisioni njëzëri i caktoi anëtarët e grupit të përbashkët të punës për Projektligjin për invalidët, për dëshmorët, për veteranët e UÇK-së: Teuta Hadri, Rita Hajzeraj dhe Flora Brovina.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz